# INSTITUTI EPIK

QERSHOR 2019

## KORNIZA E INVESTIMEVE PËR BALLKANIN PERËNDIMOR - WBIF

# HYRJE

Sa herë në dimër e ndezni ngrohjen qendrore të TERMOKOS-it, apo bëni dush në shtëpi në Prishtinë – ju jeni duke përfituar nga një instrument me emër të komplikuar “Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor”, apo shkurtë: WBIF (Western Balkan Investment Framework).

Ndërsa nëse udhëton në të ardhmen, në vitin 2025, fal WBIF-it qytetarët e Kosovës do të mund të marrin trenin në Prishtinë e të udhëtojnë nga Lisbona deri në Talin.

Në publikimin e radhës e kthejmë vëmendjen nga një storie e pa treguar suksesi – WBIF.

WBIF është instrument rajonal financiar që mbështet zgjerimin e BE-së dhe zhvillimin socio-ekonomik në Ballkanin Perëndimor duke ofruar financim dhe asistencë teknike për investime strategjike në fushën e energjisë, mjedisit, arsimit, shëndetësisë, transportit, zhvillimit të sektorit privat, dhe që nga dhjetori 2017, po ashtu në fushën e infrastrukturës digjitale.

Nëse udhëtojmë në të ardhmen, në vitin 2025, fal WBIF-it qytetarët e Kosovës do të mund të marrin trenin në Prishtinë e të udhëtojnë nga Lisbona deri në Talin.

# HYRJE

Që nga viti 2014, WBIF ka qenë instrument kyç i zbatimi të agjendës së Berlinit - iniciativë e BE-së për avancimin e lidhjes infrastrukturore në mes Ballkanit Perëndimor dhe BE-së.

Portofolio momental i WBIF-it përbehet nga 162 projekte dhe 271 grante në vlerë prej €841.7 milion, me investim të vlerësuar në 16.6 miliardë euro për gjashtë sektorë: energjia, mjedisi, sektorë social, transporti dhe zhvillimi i sektorit privat.

Në Kosovë, portofolio i WBIF-it përbehet nga 19 projekte dhe 31 grante në vlerë prej €110 milion, me investim të vlerësuar në €898 milion për katër sektorë: energjia, mjedisi, sektorë social dhe transporti.

Investimet kyçe të WBIF-it në Kosovë janë:

- Projekti i Kogjenerimit në Prishtinë;

- Rehabilitim i Linjës X Hekurudhore; dhe

- Rehabilitimi I Rrjetit Ujësjellësit në Prishtinë.

# KORNIZA E INVESTIMEVE E BALLKANIT PERËNDIMOR (WBIF)

Korniza e Investimeve e Ballkanit Perëndimor (Western Balkans Investment Framework - WBIF) është themeluar në vitin 2009 si një iniciativë e përbashkët e Komisionit Evropian, Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Bankës Evropiane të Investimeve. Banka Botërore dhe KfW janë bërë ndërkohë pjesë e WBIF-it.

WBIF është instrument rajonal financiar që mbështet zgjerimin e BE-së dhe zhvillimin socio-ekonomik në Ballkanin Perëndimor duke ofruar financim dhe asistencë teknike për investime strategjike në fushën e energjisë, mjedisit, arsimit, shëndetësisë, transportit, zhvillimit të sektorit privat, dhe që nga dhjetori 2017, po ashtu në fushën e infrastrukturës digjitale.

Përderisa zbatimi efikas i projekteve të infrastrukturës është në epiqendër të WBIF-it, vëmendje të veçantë është kushtuar fushave të cilat kontribuojnë në përmirësimin e mjedisit biznesor.

Fokusi strategjik i WBIF-it shtrihet edhe në fushën e efiçiences së energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme (REEP – Programi Rajonal për Efiçiencë të Energjisë, GGF – Fondi për Rritje të Qëndrueshme Mjedisore), si dhe zhvillimit sektorit privat (EDIF – Fondi për Inovacion dhe Zhvillim, EFSE – Fondi Evropian për Evropën Juglindore).

# STRUKTURA E WBIF-IT

WBIF

EFIÇIENCA E ENERGJISË
GGF, REEP

INFRASTRUKTURA
TA, INV

ZHVILLIMI NVM-VE
EDIF, EFSE

6 VENDE PËRFITUESE

KOMISIONI EVROPIAN

20 DONATORË BILATERAL

6 INSTITUCIONE FINANCIARE NDËRKOMBËTARE

# VENDE PËRFITUESE

TË DHËNAT NGA 1 NËNTOR 2018



Nr i projekteve: 28
Vlera e projekteve: €1.8 miliard
Vlera e granteve: €106 milion



Nr i projekteve: 25
Vlera e projekteve: €3.1 miliard
Vlera e granteve: €143 milion



Nr i projekteve: 19
Vlera e projekteve: €0.9 miliard
Vlera e granteve: €110.4 milion



Nr i projekteve: 14
Vlera e projekteve: €0.8 miliard
Vlera e granteve: €95 milion



Nr i projekteve: 14
Vlera e projekteve: €0.8 miliard
Vlera e granteve: €95 milion



Nr i projekteve: 32
Vlera e projekteve: €4.4 miliard
Vlera e granteve: €146 milion

# DONATORË BILATERAL



# ORGANIZATAT PARTNERE

# DONATORË NË WBIF

TË DHËNAT NGA 1 JANAR 2018




BASHKIMI EVROPIAN

CEB, EBRD, EIB

TRANSFER NGA WBF NË EWBJF

DONATORË BILATERAL (EWBJF)

# PORTFOLIO

Suksesi i veçantë i WBIF-it bazohet në përzgjedhjen e projekteve prioritare në Ballkanin Perëndimor, përmes ndërveprimit të ngushtë në mes:

- Granteve të ofruara nga BE dhe donatorë bilateral;

- Kredive të ofruara nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare;

- Bashkë-financimit të vet vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Që nga viti 2014, WBIF ka qenë instrument kyç i zbatimi të agjendës së Berlinit - iniciativë e BE-së për avancimin e lidhjes infrastrukturore në mes Ballkanit Perëndimor dhe BE-së. Në këtë drejtim, BE-ja ka alokuar €1 miliard për periudhën 2014-2020 për të mbështetur zbatimin e agjendës së Berlinit.

Portfolio momental i WBIF-it përbehet nga 162 projekte dhe 271 grante në vlerë prej €841.7 milion, me investim të vlerësuar në €16.6 miliardë euro për gjashtë sektorë: energjia, mjedisi, sektorë social, transporti dhe zhvillimi i sektorit privat.

Infrastruktura digjitale u shtua si sektor i ri në dhjetor 2017, dhe grant i parë u miratua në qershor 2018 është Studimi i Fizibilitetit për Zhvillimin Rajonal të Broadbandit në Shqipëri.

# WBIF NË NUMËRA

**162** NUMRI I PROJEKTEVE

**16.6** INVESTIMI I VLERËSUAR (MILIARD)

**271** NUMRI I GRANTEVE

**842** VLERA E GRANTEVE (MILION)

TË DHËNAT NGA 1 NËNTOR 2018

# GRANTET, SIPAS VENDEVE

TË DHËNAT NGA 1 NËNTOR 2018



# GRANTET, SIPAS SEKTORËVE

TË DHËNAT NGA 1 NËNTOR 2018



# GRANTET, SIPAS QËLLIMIT

TË DHËNAT NGA 1 NËNTOR 2018



# KOSOVA NË WBIF

| | |
|---|---|
| 19 | NUMRI I PROJEKTEVE |
| 898 | INVESTIMI I VLERËSUAR (MILION) |
| 31 | NUMRI I GRANTEVE |
| 110 | VLERA E GRANTEVE (MILION) |

TË DHËNAT NGA 1 NËNTOR 2018

# PROJEKTET, SIPAS SEKTORËVE

TË DHËNAT NGA 1 NËNTOR 2018



# GRANTET, SIPAS SEKTORËVE

TË DHËNAT NGA 1 NËNTOR 2018





# GRANTET, SIPAS QËLLIMIT

TË DHËNAT NGA 1 NËNTOR 2018



# STORIE SUKSESI



## PROJEKTI KOGJENERIMIT, PRISHTINË

INVESTIMI — **37** MILION

**24/7** FURNIZIM — NGA 5 ORË NË DITË TANI 24 ORË NGROHJE

REDUKTIMI I EMETIMEVE — **73%** REDUKTIM CO2

**570%** — RRITJE NË FATURIM DHE TË HYRAT

CILËSIA E MIRË E AJRIT NË PRISHTINË — **AJRI I PASTËR**

# STORIE SUKSESI




## REHABILITIMI I LINJËS 10 HEKURUDHORE

INVESTIMI

196 MILION

148 KILOMETRA

RRJET HEKURUDHOR

SHPEJTËSIA DERI MË 100 KM/H

SHPEJTËSIA DHE SIGURIA

SEETO

PJESË E RRJETIT BAZË TË EVROPËS JUG-LINDORE

PJESË E RRJETIT TRANS-EVROPIAN I TRANSPORTIT

TEN-T

# STORIE SUKSESI



REHABILITIMI I RRJETIT UJËSJELLËSIT, PRISHTINË

INVESTIMI **55** MILION

**24** ORË

FURNIZIM ME UJË PËR PRISHTINËN, FUSHË KOSOVËN, KASITRIOTIN, SHTIMEN, LIPJANIN, BESIANEN, DRENASIN

ZVOGËLIMI I RISKUT PËR SHËNDETIN PËRMES SISTEMIT TË AVANCUAR TË PRESIONIT

**SHËNDETI**

**KUALITETI I UJIT**

PROCESI I AVANCUAR I TRAJTIMIT TË UJIT

INSTITUTI I KOSOVËS PËR POLITIKAT EVROPIANE, 2019.
TE GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA.